Kronikë

SKEDA/ Kush janë të arrestuarit nga mega-operacioni në Elbasan! Nga anëtari i grupit të Çapajve, tek shpërndarësit e kokainës e heroinës

45 persona anëtarë të grupeve që shisnin drogë u arrestuan nga policia e Elbasanit e cila shpalli në kërkim 7 të dyshuar të tjerë. Aksioni u shtri në shtatë qytete ndërsa mes të arrestuarve, ka edhe anëtarë të bandave kriminale. Report Tv sjell skedën e disa prej të arrestuarve, të cilët janë emra të njohur për policinë, pasi rezultojnë më të shkuar kriminale

■ Hekuran Gjeli pjesë e grupit të Çapajve! I arrestuar më parë për armëmbajtje pa leje (FOTO)
■ Elbasan/ Goditen 4 banda të trafikut të drogës: 45 të ndaluar, transferohen në Tiranë, 7 në kërkim!
Sekuestrohen 51 mln lekë, kokainë e heroinë! Ja të gjithë emrat

Hekuran Gjeli

Sokol Dema
29 Qershor, 14:45 | **Përditësimi: 29 Qershor, 18:36**

45 persona anëtarë të grupeve që ***shisnin drogë*** u arrestuan nga policia e Elbasanit e cila shpalli në kërkim 7 të dyshuar të tjerë. Aksioni u shtri në shtatë qytete ndërsa mes të arrestuarve, ka edhe anëtarë të bandave kriminale. Report Tv sjell skedën e disa prej të arrestuarve, të cilët janë emra të njohur për policinë, pasi rezultojnë më të shkuar kriminale.

Një prej 45 të ndaluarve në Elbasan si pjesëtar të grupit të shkatërruar kriminal për prodhim dhe trafik droge, është Hekuran Gjeli, një emër jo pak i njohur për bluté e qytetit. Gjeli rezulton të jetë pjesë e grupit të Çapajve, ndërsa më herët është arrestuar për armëmbajtje pa leje. Burime nga policia bëjnë me dije se personat e arrestuar kanë pasur kryesisht rol dominues në zonat ku kanë kryer shpërndarjen e lëndës narkotike.

[Sh .com]

LEXO EDHE:
Librazhd, 'Mitsubishi' del nga rruga, 6 të plagosur, mes tyre, 2 fëmijë të moshës 2 - 9 vjeç

Erist Skilja, i arrestuar nga Policia e Elbasanit në mesin e 45 të tjerëve për shpërndarje dhe trafik droge është emër i njohur për drejtësinë. Ai dyshohet se në vitin 2019, së bashku me Thanas Bekon, kanë marrë peng kushëririn e gjyqtares së Elbasanit, Zamira Vyshka, Andi Vyshka. Në atë kohë Andi Vyshka ka treguar se është marr peng nga Beko dhe Skilja, të cilët i kanë marr edhe shumën prej 2 mijë eurove. Vyshka pohoi aso kohe se ishte duke konsumuar birra në ambientet e karburant "Krasniqi", pronë e Ilir Bekos. Fillimisht sipas tij ishte larguar për të përcjelë një shoqen e saj, por ishte rikthyer pasi kishte harruar telefonin. Ky ka qenë momenti që është mbajtur nga Beko dhe Skilja. Vetë Andi Vyshka është shprehur në atë kohë se e kanë detyruar të pinte birra dhe drogë.

Albi Biçaku është një tjetër person i arrestuar nga policia, por me të shkuar kriminale. Më 21 shkurt të këtij viti, 27-vjeçari qëllloi me armë zjarri në drejtim të një lokali në Librazhd ku ndodhesh disa të rinj. Si pasojë mbeti i plagosur në këmbë Shpëtim Skura, i cili ndodhej rastësisht në tavolinë. Menjëherë pas ngjarjes autori u largua me makinë dhe prej shkurtit rezultonte person në kërkim.

Tre persona u arrestuan në Elbasan për shpërndarje të lëndëve narkotike në gusht 2021, mes tyre edhe Ahmet Kushi. Arrestimi i këtyre u bë pasi në lagjen "5 Maji", gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e Ahmet dhe Aleksandër Kushit, vëllezër, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale doza me lëndë narkotike të dyshuar heroinë. Më tej gjatë kontrollit u gjetën 3 aparate celular, një peshore të vogël që shërbente për peshimin e lëndës narkotike, një sasi municioni luftarak, kokra të bardha të dyshuara si metadon dhe një sasi parash të përfituara nga shitja e lëndës narkotike.

Pesë persona u arrestuan nga Policia e Elbasanit për prodhim dhe shpërndarje të lëndëve narkotike në 2015-ën, në mesin e të cilëve edhe Storado Sadushi, në atë kohë 20 vjeç. Gjatë operacionit u sekuestruan 1kg e 800 gr heroinë, 380 gr kokainë, 3 gr kanabis sativa, 20 gr fara kanabis sativa, 670 fishekë, 400 euro, 7 aparate telefonash celulare, dy peshore elektronike.

Rezarta Isufaj u arrestua në 10 qershor të këtij viti në Elbasan pasi në banesën e saj u gjetën 400 doza kanabis sativa dhe 1 kg tjetër që mbaheshin për qëllim shitje. Bashkë me të në pranga ra edhe i biri Franko Elmazi.

Në janar 2018 Policia e Tiranës arrestoi 5 persona, për shpërndarje kokaine. Mes tyre u arrestua edhe Shpëtim Myrta, në atë kohë 51 vjeç, banues në Elbasan, i dënuar më parë. Arrestimi u bë pasi këta persona në bashkëpunim me njësi-tjetrin shisnin lëndë narkotike e lloji të dyshuar "Kokainë" klientëve kryesisht në zonën e Oxhakut, Xhamllikut në qytetin e Tiranës. Atyre iu sekuestruan 2 automjete dhe 8 telefona celularë.

Edor Hasanllari rezulton i arrestuar në 2016-ën për grabitje të disa dyqaneve në Peqin. Arrestimi i tij u bë në fshatin Vashaj, me mjetin e tij, tip "Benz" vodhi me thyerje dyqanin me artikuj të ndryshëm në pronësi të shtetasit, por edhe në raste të tjera.

Aldo Gjeli, i arrestuar më herët për vjedhjen në bashkëpunim me persona të tjerë të një magazine dhe mobiliere në 2011-ën. Rudolf Korumi 39 vjeç, u arrestua në flagrancë në fund të vitit 2022 nga Policia e Elbasanit pasi gjatë kontrollit fizik dhe në banesën, iu gjetën dhe sekuestruan, një sasi lëndë të dyshuar narkotike kanabis, të ndarë në doza, gati për shitje.

M.Q./A.M./Shqiptarja.com

TAG: Elbasan | operacion antidrogë | Hekuran Gjeli | erist skilja | Thanas Beko | zamira vyshka | albi bicaku | ahmet kushi | aleksander kushi | storado sadushi | rezarta isufaj | shpetim myrta | edor hasanllari

Komento

Komente

Gena: 29/06/2023 19:49

Pa dashur te mohoje punen e askujt ! abravo per goditjen por megaoperacion me 50 vete dhe 50 mije eruo me duket pak si arritje imagjinare sidomos kur kane shpetuar te gjithe kreet e Elbasanit. Keshtu qe uleni nga pak dozen e ekzagerimit. Se kane kapur fukarenj bosat i dine ku i kane! Respekte punonjesve te policise por merrunii edhe me ata qe jane koka mos harroni! Deri aty ku tju lene!

Përgjigju

Ndalohet reprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Partitë e vogla propozojnë të votojnë edhe 16-vjeçarët, jeni dakord?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Një prej 52 të shoqëruarve nga policia në Elbasan, Hekuran Gjeli pjesë e grupit të Çapajve! I arrestuar më parë për armëmbajtje pa leje (FOTO)
29 Qershor, 11:58

Elbasan/ Goditen 4 banda të trafikut të drogës: 45 të ndaluar, transferohen në Tiranë, 7 në kërkim! Sekuestrohen 51 mln lekë, kokainë e heroinë! Ja të gjithë emrat
29 Qershor, 08:43

Përfundon ndërtimi i nënkalimeve dhe i 60% prej veprave të artit për aksin Elbasan-Qafë Thanë! Rama: Vijon puna për ta kthyer në rrugë me 4 korsi
29 Qershor, 08:41

Report Tv sjell historinë e maturantit 20-vjeçar, zgjedh Ekonomikun sepse fakulteti ka ashensor! Anxhelo Duhanxhiu: Kam shpresë se do të ngrihem në këmbë

Ronaldo Gjoshi
27 Qershor, 17:33

Kultivuan lëndë narkotike në fshatin Seltë në Elbasan, 2 të arrestuar, 1 në kërkim
27 Qershor, 11:48

U mor nga rrjedha e madhe e ujit, ndërron jetë roja i kanalit vaditës në Librazhd
27 Qershor, 11:24

Heroinë e kanabis nga Turqia e Siria, kokaina nga Shqipëria në BE! Vlera 2.7 mln euro! Mes 20 të arrestuarve 1 polic, 1 në kërkim! Droga vinte me kamiona

Sokol Dema
27 Qershor, 10:41

Ishte shpallur i zhdukur nga familja, gjendet i pajetë 46-vjeçari në Elbasan
26 Qershor, 20:13

Shkëndija elektrike u dogji banesën, prej 3 ditësh familja në Belsh në qiell të hapur! 3 fëmijët: Kemi frikë natën

Ronaldo Gjoshi
24 Qershor, 15:35

Përmbyset zetori, vdes duke punuar tokat 20-vjeçari nga Peqini
23 Qershor, 12:36

'Qershi dhe dashuri', festa e cila promovon produktet e zonës së Godoleshit në Elbasan
22 Qershor, 19:06

Afera me inceneratorin e Elbasanit, shtyhet seanca! Të pandehurit kërkuan kohë të përgatisin mbrojtjen
22 Qershor, 16:01

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje